ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Shendetesise – MSH**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-23-11488-1-1-1**

Sa i përket tenderit për ***"Furnizim me paisje mjekesore, instrumente mjekesore për njësitë organizative te QKUK-se" – LOT 8***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Medi Health L.L.C.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Preoc, Magj. Ferizaj - Prishtinë, p.nr
(Adresa)
Graçanicë
(Vendi) *(Kodi postar)*
+38344900523
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*
Eltion Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
medihealthllc1@gmail.com
(Adresa elektronike)
01.07.2024
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

NUI 812072677 Medi Health L.L.C. Preoc, Llapllasellë GRAÇANICË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit te ankeses) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shënoni një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin ne te cilen eshte publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhenie te Kontratës", "Njoftimi per Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nese aplikohet, afatin e fundit per dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit te procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhenie te kontratës]:

Njoftimi për kontrate 24.10.2023 Hapja e ofertave 23.02.2024 Njoftimi mbi vendimin 1 – 02.04.2024 Kerkesa për ri shqyrtim 07.04.2024 Vendimi i AK -MSH ndaj kerkeses për ri shqyrtim 30.04.2024 Vendimi i AK – rivleresimi – 27.05.2024 Kerkesa për ri shqyrtim 01.06.2024 Vendimi i AK – MSH – Refuzimi i kerkeses 21.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Hapja e ofertave 23.02.2024

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Operatori Ekonomik ankues Medi Health L.L.C, me datën 01.06.2024, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim kundër vendimit te Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shendetesise dhe ka prezantuar prova, dëshmi dhe argumente tjera te mbeshtetura me dispozita ligjore edhe për kundër ketije fakti AK – MSH, perseri refuzon kerkesen tone per ri shqyrtim si te pa bazuar, ndersa vendimin – propozimin per dhenie te kontrates e ne fuqi dhe rekomandon per dhenie te kontrates oferte te pa pergjegjeshme ne aspekt administrativ, financiar dhe teknik ndërsa ofertën tone e eliminon si te pa pergjegjeshe. Vednimi i AK-se, nxjerrët pas 20 ditesh dhe me kete shkelet edhe neni 108/A i LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për prokurim publik, nr 04/L-042 i amandamentuar meligjet tjera

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
Neni 130 Ndikimi i Paligjshëm
Neni 131 Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues

Rregullorja për prokurim publik nr. 001/2022

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 97 Shkeljet e rënda

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Kjo procedure e prokurimit është karakterizuar me shkelje esenciale apo thelbesore te parimeve për prokurim publik dhe te dispozitave ligjore për prokurim publik, nga zyrtaret përgjegjës te prokurimit tek Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shendetesise.

Fillimisht operatori ekonomik ankues "Medi Health" LLC, me datën 02.04.2024, sipas letres standarde ne vleresimin fillestar është kualifikuar si oferte e pergjegjeshme lidhur me lotin 8, "*Furnizimi me pajisje për zhvillim te procesit teaferezes për Kliniken e Nefrologjise*", është rekomanduar për dhënie te kontratës dhe me datën 28.03.2024, na janë kerkuar qe te dorezohen kerkesat e pershtatshmerise si parakusht i lidhjes se kontratës.

Prove njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 02.04.2024 se bashku me dëshmitë lidhur me kerkesat e pershtatshmerise profesionale.

Pas njoftimit mbi vendimine AK – MSH, propozimit për dhënie te konstrates, gjegjesisht kerkeses për ri shqyrtim te datës 04.04.2024, te operatorit ekonomik pjesemarres ne këtë proces te prokurimit, "Argo Med" shpk, AK – MSH, e kthen procesin ne ri vleresim, ndërsa kompanin tone e eleminon si te pa pergjegjeshme, prandaj bazuar ne nenin 109 te LPP-se dhe ne afatine parapare parashtrojme këtë:

A N K E S E

PRETENDIMI ANKIMOR 1.

Oferta e Operatorit Ekonomik ankues "Medi Health" LLC, lidhur me proceduren e prokurimit te sipër pershkruar për lotin 8, fillimisht me datën 02.04.2024 është kualifikuar si e pergjegjeshme dhe si e tille është rekomanduar për dhënie te kontratës, nga komisioni profesional i autorizuar nga vet AK – MSH, eshte konfirmuar edhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, rrjedhimisht arsyetimi i eleminimit te ofertës sonë pas procesit te ri vlerësimit paraqet shkelje te Nenit 52.3, 56.3 dhe 59 i LPP-se.

Për këtë procedure te prokurimit pervec shkeljeve ligjore janë konsumuar edhe shkelje procedurale me qellimin e vetëm demtimin e buxhetit, favorizimin e OE tani te rekomanduar dhe diskriminimin e kompanis sonë ankuese. Ne vleresimin fillestar ne si operator ekonomik jemi propozuar për dhënie te kontratës (prove njoftmin e publikuar ne e-prokurim)

Pas rekomandimit për dhënie te kontratës AK – MSH, ka pranuar kerkese për rishqyrtim nga OE "Argo Med" shpk me datën 07.04.2024. Kundrejt kesaje kerkese Autoriteti Kontraktues – MSH, gjegjesisht zyrtari përgjegjës i prokurimit nxjerr vendim rreth 23 dite pas afatit ligjor, aprovon te njejten kerkese dhe lenden e kthen ne rivleresim përkundër faktit se nuk ekziston kurrefare baze ligjore. Ky veprim tregon qarte për negocim te mundeshem, abuzim dhe keqperdorim ne prokurim publik, madje pas ri vlerësimit operatori ekonomik "AgroMed" shpk propozohet per kontrate.
Favorizimi abuzimi dhe qellimi i caktuar tregohet ne rastin e vendimit te dates 30.04.2024, ku AK – MSH, aprovon kerkesen per ri shqyrtim te OE "Argomed" shpk, lenda kthehet ne ri vleresim ne njeren ane dhe ne anen tjeter potencohet pa pergjegjeshmeria e te njejtit OE dhe ate me arsyetimin se paisja nuk posedon UPS dhe aparatin per kalibrim sic eshte kerkuar ne pika 7.3 dhe 7.4. te specifikave teknike te detyrueshme per lotin 8.

Kompania jone ne afatin e rregullt rekomandimin për dhënie te kontrates per OE "Argomed" shpk, pas ri vleresimit te ofertave, gjegjesisht arsyetimin e eleminimit e ka kundershtuar me datën **01.06.2024**, sipas kerkeses për ri shqyrtim. AK – MSH, për te trajtuar këtë kerkese, për te tentuar për te manimpuluar me prova dhe dëshmi dhe për te abuzuar me paran publike nxjerr vendim refuzues dhe atë pas 20 diteve gjegjesisht me daten 20.06.2024 refuzon kerkesen tone si te pa bazuar!

Nenin 108/A, par 6 te LPP-se kjarte përcakton afatin për vendosje dhe nxjerrje te vendimit ku i njejti afat është jo me shume se 3 dit pune dhe ne raste komplekse mund te vazhdohet afati edhe per 3 dite tjera por duhet te nxirret vendim i veqant për zgjatje te afatit.

> "*Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë*".

Veprimet recidiviste te tilla duhet te raportohen dhe duhet te kerkohet te ndermirren masa ligjore meqe mos respektimi i rregullave për trajtim te kerkeses për ri shqyrtim pran AK, sipas pikës **e)** te nenit 97, te rregullores nr. 001/2022, konsiderohet si shkelje e rende.

Kjo përgjegjësi do duhej te bie mbi zyrtarin përgjegjës te prokurimit, për keso veprimesh recidive do duhej te inicohej procedure ne kuptim te nenit **25.8**, te LPP-se dhe te njoftohet KRPP, me këto veprime.

Përkundër faktit se ne vendim ndaj kerkeses për ri shqyrtim te nxjerre diten e 23, (ne rivlersimin fillestar), përkatësisht ne diten e 20 (ne vendimin e dyte te datës 20.06.2024), ne vend se te trajtohen pretendimet ankimore te arsyetohen veprimet dhe eleminimi i ofertës sone, kerkohet meshire, kerkohet mirekuptim, tenohet te shpetohet nga pergjegjesia ligjore, gjegjesisht arsyetimit te pretendimeve tone iu jepet konotacion vajtues dhe pershkruhet se si pacientet po trajtohen jasht vendit, se si ka qene zyrtari i obliguar te prese pergjigje, apo dhe nuk ka pranuar pergjigje nga prodhuesi yne B.Branun, madje edhe konfirmimi i prodhuesit deformohet, rrjedhimisht akuzohemi ne si kompani pse kërkojmë pergjigje për shkelje ligjore!

PRETENDIMI ANKIMOR 2.

Operatori Ekonomik ankues, pas nxjerrjes se vendimit – refuzimit te kerkeses per ri shqyrtim te dates 20.06.2024, i eshte drejtuar AK-se, me kerkese per qasje ne dokumente per kete procedur te prokurimit, perkunder kesaje AK – MSH, nuk ofron qasje dhe nuk pergjigjet fare ndaj kerkeses sone te parashtruar me daten 26.06.2024.

Prove: Kerkesa per qasje ne dokumente e dates 26.06.2024.

Kerkese per qasje ne dokumenta

Medi Health <medihealthllc1@gmai... Wed, Jun 26, 10:19 AM (5 days ago)
to Berat, Egzon

Pershendetje te nderuar,

Bashkëngjitur gjeni kerkesen per qasje ne dokumente bazuar ne Nenin 10 te LPP-se per lenden me titull: Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative te QKUKsë" me nr. prokurimi 206-23-11488-1-1-1 per LOT 8.

Shpresojme qe ta na ofroni qasjen sa me pare.

Me respekt,
Elion Krasniqi
Medihealth L.L.C
Graçanice
Mob.+383 44 900 523

One attachment • Scanned by Gmail

Kerkese per qasj...

AK – MSH, ka mohuar qasjen dhe me keto veprime ka konsumuar shkelje nga neni 10 i LPP-se nga paragrafi 3 deri ne paragrafin 5 ku percaktohet:

3. *Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur...*

4. *Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.*

5. *Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.*

Mos ofrimi i qasjes ne dokumente publike, konsiderohet si shkelje e rende e ketij ligji bazuar ne nenin 97, te Rregullores me nr 001/2022, per prokruim publik pika **c)**

c. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

PRETENDIMI ANKIMOR 3.

Arsyetimi i eleminimit te kompanise sonë me pershkrimin e poshte pershkruar dhe arsyetimi i pershkruar ne vendimin e datës 20.06.2024 është abuzues dhe ka qellim te caktuar. AK – MSH, paisjen tone e deformon dhe e quan "Bbraun OMNI Ecco2R", perderisa paisja jone e ofertuar quhet "Bbraun OMNI", rrjedhimisht katallogu i prezantuar ne ofertën tone deformohet keqinterpretohet dhe tentohet te manipulohet dhe nuk i referohet pozicioneve dhe pershkrimeve te nenvizuara dhe nuk krahasohet me kerkesat e dosjes se tenderit apo specifikacionet teknike te detyrueshme.

Aparati, gjegjesisht paisja e prezantuar ne oferte e prodhuesit "Bbraun OMNI", i realizon te gjitha funksionet e specifikave teknike te detyrueshme perfshire edhe TPE. AK – MSH, me qellim te manipulimit dhe eleminimit te ofertës sonë, këtë e shperfaq haptazi ne shkresa dhe pershkruan se ne si kompani nuk kemi prezantuar setin per kryerjen e funksioneve CRRT dhe TPE, kjo gje nuk qendron, pasi kompanija jone ne oferten e prezantuar ka ofruar te gjitha llojet e Sete-ve qe ofron prodhuesi per kete paisje, te cilat mund ti gjeni ne dokumentin e prezantuar ne oferte me titull: ***"2. OMNI_brochure e nenvizuar-Specifikimi teknik pjesa e trete"*** ne faqen 12, ku eshte i perfshire edhe produkti **OMNI Set Plus** me te cilin mund te trajtohet **Sepsa** e konfirmuar nga vete prodhuesi, perveq kesaj kemi ofruar edhe setin per "OMNI ECCO2R", set ky i cili NUK është kerkuar ne dosje te tenderit apo specifika teknike te detyruesheshme por me kete kemi dashur te tregojme qe produkti yne "Bbraun OMNI", pervec qe realizon te gjitha funksionet e kerkuara ne FDT, trajton edhe largon CO2 nga gjaku i pacientit dhe ky fakt është dhe do duhej te ishte shume i rendesishem për pacientet te cilet i nenshtrohen ketije trajtimi.

Arsyetimi se paisja jone nuk ploteson piken a) dhe b), nuk është asgje tjetër përveç menipulimit dhe tentimit te keqperdorimit te paras publike dhe dispozitave ligjore apo shktremberimit te gjendjes faktike.

Ky insistim për manipulim, keqperdorim, abuzim dhe eleminim te ofertës sone do duhej te mbetet vetëm ne tentative dhe nuk do duhej te lejohej te konkretizohej, pasi qe paisja jone "BBraun OMNI" i ploteson te gjitha kriteret dhe specifikacionet teknike ashtu siç është kerkuar.

Ne vlereimin fillestare te ofertave pikerisht për këtë procedure ne si OE jemi rekomanduar për dhënie te kontrates, ku sipas raportit te vlerësimit fillestar te ofertave anëtaret e komisionit vleresues kane qene profesionist te fushes dhe objektit te kontratës.

Aparati dhe produkti yne largon te gjitha komponentet patogjene nga plazma e gjakut (kete e ka konfirmuar edhe pergjegja e prodhuesit) term ky i cili perdoret për te gjithë shkaktaret e gjendjes septike, përkatësisht pastron gjakun nga çdo komponent toksik, rrjedhimisht ky produkt dhe kjo paisje është nder paisjet me te persosura dhe si e tille i ploteson te gjitha specifikat teknike te aplikara ne dosje te tenderit.

Madje aparatuara dhe produkti BBraun OMNI, përveç funksioneve te aplikuara ofron edhe funksione tjera ne dobi te pacienteve.

Prove: Deshmit nga katalogu i prodhuesit te paisjes "B.Braun", sa i përket pikave te eleminimit.

Pika 1.2
1.3
1.4

2.9 Clinical Benefits

2.9.1 Clinical Benefits of Continuous Blood Purification Treatment

Continuous blood purification provides a life-saving treatment and includes the following clinical benefits:

- Removal of excess fluid
- Removal of uremic retention solutes and toxic molecules (small- and middle-molecular weight)
- Electrolyte removal and control
- Acid-base adjustment

2.9.2 Clinical Benefits of Therapeutic Plasma Exchange

Therapeutic plasma exchange provides the following clinical benefits:

- Removal of pathogenic plasma components
- Replacement of pathologically modified plasma by plasma substitution fluid

BICARBONATE BASED SOLUTIONS

PERSONALIZING THERAPIES

The patients conditions can change often and require adaptions of renal replacement therapy. Fluid management is one of the major and most frequent therapeutic challenge. Patients afflicted with acid-base disturbances require an adequate buffering which is an important component of successful treatment. To accomplish these objectives a careful selection of the most suitable solutions for each patient is necessary.



Aparati mund te perdoret edhe per trajtimin e rasteve te paraqitura ne kete grafion.

CLINICAL CHARACTERISTICS
- Correction of metabolic acidosis
- Low cardiovascular complications
- Physiological buffer solution

REFERENCES

3

Pra arsyetimi i eleminimit te kompanis sonë, nuk është asgje tjetër përveç tentimit për keqperdorim dhe abuzim me parane publike. Arsyetimi se ne nuk kemi prezantuar "Set-et" është absurd, pasi qe eshtë kerkuar, qe se bashku me aparaturen te dorezohen setet për Plazma Exchange (30), Sepse (30) dhe te gjitha format e CRRT (nga 10), rrjedhimisht nuk është kerkuar qe paisja ti këtë te inkorporuara këto produkte dhe te njejtat produkte sipas aneksit 1 – Specifikacionet teknike te detyrueshme jane materiale hargjuese dhe per te njejtat nuk eshte kerkuar deshmi apo katalog sic eshte kerkuar per paisjen kryesore.

Për te gjitha specifikat e kerkuara te produktit ne kemi prezantuar katallogun, kemi prezantuar deklaratat dhe deshmit tjera te cilat janë pjese e ofertës, janë pjese e sqarimeve dhe plotesismeve sipas kerkeses se AK-se. Te gjitha këto janë deshmuar janë prezantuar dhe AK – MSH është ne dijeni me këto fakte. Cili është qellimi i eleminimit tentimit te abuzimit do duhej te vertetohej ne procedure tjetër.

Ne në oferte kemi prezantuar deklaratën qe do ti ofrojme setet e kerkuara, gjegjesisht specifikacionet teknike te detyrueshme "Bbraun OMNI", dhe specifikimet e nenvizuara te paisjes. Për këtë qeshtje AK – MSH, ka kekuar sqarime shtese, ne kemi ofruar sqarim por prap AK – MSH, deformon gjendjen faktike, te cilen ne asnje rrethane nuk do te lejojme te deformohet.

I gjith arsyetimi i eleminimit apo tentativa për eleminim te ofertës, konsumon shkelje ligjore nga neni 52.3 dhe 56.3 te LPP-se ku shprehimisht percaktohet:
"*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Per kete qeshtje AK – MSH, zyrtaret pergjegjes te saje tek arsyetimi i eleminimit te ofertes sone, gjegjesisht ne arsyetimin e dhene ne vendimin e dates 20.06.2024, per kunder faktit se ka marr konfirmin nga prodhuesi i paisjes BBraun se paisja e trajton SEPSEN, AK-MSH deformon pergjigjen dhe konfirmimin e dhene nga prodhuesi i paisjes dhe me ngulm deklaron se paisja nuk e trajton SEPSEN. Ngjashem AK MSH, ne te nejtin vendim potencon se paisja nuk disponon filterat, perkunder faktit se prodhuesi BBraun, sipas pergjigjes se dates 20.06.2024, ka potencuar se paisja eshte kompatibile me filterat e prodhuesve tjere per te cilet ne si kompani kemi ofruar deklarate dhe kemi konfirmuar se do te ofrojme produktet e tilla ashtu sic eshte percaktuar ne DT dhe specifikacione teknike te detyrueshme.

Prove: Komunikimi i AK – MSH, dhe pergjegja e prodhuesit "Bbraun" e dates 20.06.2024.

Reply Reply All Forward

Thu 6/20/2024 11:32 AM

Gordon Völksen <gordon.voelksen@bbraun.com>

WG: Request for clarification (Ministry of Health/Kosovo)

To Besel Mustafa

Cc [illegible]

Retention Policy Default (5 years) Expires 6/19/2029

You forwarded this message on 6/21/2024 8:04 AM.

2. OMNI_brochure_enl... 6 MB | OMNI_ProductDataShe... 51 KB | omni-sepsis-setup-gu... 570 KB | OMNI_Specifikimi i ne... 8 MB

Action Items

+ Get more

Dear Mr. Mustafaka,

thank you very much for your e-mail and your kind call earlier today.
Please excuse the shortage of our conversation as I had been in between two appointments.

Regarding your request for information, we have compiled following pieces of information for you:

1. Does this device perform the required function no. 1.4 does it treats the patients with septic conditions?
- Yes, OMNI® is able to perform therapies that reduce the load of endogenous inflammatory toxins in the circulation (e.g. in septic conditions). These therapies are possible using OMNIset® Plus, compatible with most Adsorbers available in the market, such as CytoSorb and Jafron, in conjunction with CRRT.

2. Does the device treat sepsis?
- OMNI® itself does not treat sepsis, as OMNI® is a medical platform for extracorporeal blood purification treatments. Sepsis treatment with OMNI® is possible using OMNIset® Plus, compatible with most Adsorbers available in the market, such as CytoSorb and Jafron, in conjunction with CRRT.

3. Does B.BRAUN produce filters for the treatment of septic conditions?
- No, B. Braun does not produce filters or adsorbers for the treatment of septic conditions.

4. Confirm if the catalogs are authentic for the devices in question.
- Catalog, brochure, data sheet and IFU provided as attachments to the previous email are authentic for B. Braun OMNI® device.

Please do contact me in case of further and/or additional question.

Trust to having been of assistance, I remain with best regards,

Gordon Völksen
Area Sales Manager | Eastern Europe & The Balkans
+49 151 14947336
gordon.voelksen@bbraun.com

B. Braun Avitum AG - part of the B. Braun Group
Global Marketing & Sales
Schwarzenberger Weg 73-79
34212 Melsungen
Germany

www.bbraun.com
www.linkedin.com/company/bbraun-group

As a true partner
we develop smart solutions

AK – MSH, zyrtari pergjegjes i prokurimit, per kete procedur te prokurimit ne vazhdimesi tenton te lajthis vendimmarrjen te lajthis zyrtaret tjere perfshire edhe anetaret e komisionit ri vleresues te ofertave si dhe ne pergjigje ndaj kerkeses sone per ri shqyrtim te dates 01.06.2024, deformon kerkesat kualifikuese, deformon specifikacionet teknike per paisjen e lotit 8, dhe me keto veprime meton per manipulim dhe mashtrim ne prokurim publik.

Ne dosje te tenderit, ne aneksin 1 te DT-se shume kjarte percaktohet qe per paisjen e lotit 8, nga pika 5 per produktet dhe per setet per te cilat tentohet te eleminohet kompania jone eshte percaktuar qe: " *OE duhet te ofroje dhe dorezoje se bashku me aparatin Set-et e kerkuara si dhe siguroje disponueshmeri per te gjitha setet"* ,rrjedhimisht per keto produkte dhe materialin hargjues te paisjes AK- MSH nuk ka kerkuar, katalog apo kerkese tjeter kualifikuese ne Dosje te Tenderit, por ne pergjigjen e Kerkeses tone per Rishqyrtim te dates 20.06.2024

Zyrtari i AK-MSH tei jashte kerkesave te FDT-se dhe deklaron se ne nuk kemi ofruar dokumente si Autorizimi, CE Certifikata, Katallogu per piken 5 te Dosjes se Tenderit, ne te cilen askund nuk permenden keto dokumente, por vetem kerkohet qe te dorezohen se bashku me paisjen.

6. **Prove:** pershkrimi i ankesi 1 te DT-se per lot 8, pika 5.

5 Accesories configuration System, spares and consumables

Sl Name Technical Specifications quoted by Providers Deviation if any.

5.1 System as specified -

5.2 Thirty (30) disposable plasma exchange therapy kits and sets, thirty (30) for sepsis, and ten

(10) for each form of CRRT, must be provided and delivered with the equipment.

5.3 All consumables necessary for the installation and standardization of the system should be

provided free of charge.

5.4 To ensure the availability of sets (kits) for all procedures for 5 years. The operator agrees

with the written agreement not to change the cost over 10% of their value, since the

initiation of the agreement.

PRETENDIMI ANKIMOR 4.

Ne anen tjetër, Autoritet Kontraktues – Ministria e Shendetesise, ka rekomanduar për dhënie te kontratës oferte te pa pergjegjeshme ne aspektin financiar dhe aspektin teknik te konfirmuar me vendimin e vet AK - MSH te datës 30.04.2024, por quditerisht tani e njejta oferte u be e pergjegjeshme dhe rekomadohet për dhenie te kontratës.

Paisja e prezantuar dhe ofertuar nga Operatorit Ekonomik "Argomed shpk", permban çmim dukshëm me te larte se oferta jone, nuk i ploteson specifikat teknike te detyrueshme dhe këto veprime paraqesin shkelje ligjore dhe shkelin kriterin e dhenies cmimin me te ulet dhe kjo dergon ne keqperdorim te paras publike dhe demtim te buxhetit e saksionuar me LPP dhe ligje tjera.

Vet AK – MSH ne vendimin e dates 30.04.2024 ka potencuar se oferta e te njejti është e pa pergjegjeshme.

Prove:Arsyetimi i vendimit te AK – MSh, i dates 30.04.2024.

2. Pajisje për ndarje të qelizave të gjakut - Pajisja Aferezë (Operatori Ekonomik ankues ka ofertu me pajisjen BAXTER PRISMA FLEX dhe si pajisje i ofron të gjitha specifikat e kërkuara nga DT mirpo mungojnë pikat e poshtë shënuara.

7.3 Suitable maintenance free battery UPS for minimum one-hour backup shall be supplied with the system.

7.4 List of equipment available to provide calibration and routine preventive maintenance support, according to the manufacturer's documentation in the service/technical manual.

Por kete pretendim ankimore te kompanise tone qe e kemi cekur ne Kerkesen per Rishqyritm, AK – MSH, sipas vendimit te dates 20.06.2024, te nxjerr jasht afatit ligjore nuk e ka trajtuar fare dhe me kete ka shkelur dispozitat e nenit 108\A te LPP-se, paragrafi 8 pika 4.

8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:
8.4 Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij ***në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.***

AK – MSH, përgjatë proceseve te ri vlerësimit me cdo kusht kerkon rekomandimin dhe lidhjen e kontratës me oferte te kunderligjeshme e cila nuk i ploteson sepcifikacionet teknike te deryrueshme te vete konfirmuara. Sipas kerkesave për sqarim ne si OE dyshojme thelle se AK – MSH, ka pranuar pergjigje, ka pranuar dokumente dhe ka pranuar produkte te cilat fare nuk kane qene pjese e ofertës, rrjedhimisht pranon plotesim te ofertës ne aspekt material e cila është e ndaluar rreptesisht sipas dispozitave ligjore për prokurim publik si tërësi dhe nenit 59 ne veqanti.

Ne Aneksi 1 - Specifikacione teknike te detyrueshme ne piken 7.3 dhe 7.4, eshte kerkuar qe paisja te posedoj UPS dhe aparatin per kalibrim te paisjes, gje te cilen Operatori Ekonomik "Argo Med shpk" nuk e ka ofruar, kjo e konfirmuar nga vete AK-MSH.

Prandaj, bazuar ne provat dëshmitë dhe faktet e prezantuara si me sipër, kërkojmë qe OSHP, fillimisht për trajtim te kesaj ankese te autorizoj ekspert te fushes, me kualifikim profesional nga fusha **NEFROLOGJISE**, dhe ne kuptim te nenit 113, te LPP-se, te trajtohen te gjitha pretendimet tona ankimore ne aspektin teknik dhe sa i përket aspektit ligjore te autorizohet ekspert shqyrtues ligjore njohes i dispozitave ligjore dhe i pa anshem - i pavarur, ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Të aprovohet ne tërësi si e bazuar ankesa e OE "Medi Health" **si e bazuar.**
II. Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 27.05.2024, per lotin 8, si i kunderligjeshem dhe lënda te kthehet ne **Rivleresim;**
III. Të kualifikohet si e pergjegjeshme oferta e OE ankues: "**Medi Health**" LLC – Prishtine, me cmimin me te ulet;
IV. Të lejohet kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses dhe
V. Të ndërmerren masa ligjore ndaj zyrtareve pergjeshes për veprime dhe mos veprime kundërligjore te percaktuara me dispozita ligjore dhe te argumentuara me prova, sipas nenit **25.8**, te LPP-se.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te medha por ne procedur tjera eventuale do te kerkohet qe te komspensohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*